



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 311, datë 18.12.2019

PËR
TRANSFERIMIN E GJYQTARIT Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 44, pika 1, shkronja “b” dhe pika 2, shkronja “b”, si dhe nenin 162, pikat 1, 3 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi relacionin përkatës dhe materialet e nevojshme, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda z. {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke filluar nga data 19.12.2019.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR